



BONUSI PËR EKSKURSIONE NGA DHOMA E PUNËTORËVE

migrare ofron këshillim për Bonusin e Ekskursionit nga AK (Dhoma e Punëtorëve)

Dhoma e Punëtorëve në Austrinë e Epërme (AK OÖ) mbështet prindërit për ekskursione dhe aktivitete shkollore (p.sh. shëtitje njëditore, ditë prezentimi, kurse te skijimeve ose javë gjuhësore).

Për këtë ndihmë kanë të drejtë anëtarët e AK OÖ që kanë fëmijë në klasën e 5-të deri në të 9-tën, fëmijët e të cilëve marrin pjesë në një ekskursion të paguar. Ata mbështeten me 75 euro për ekskursione njëditore ose 150 euro për ekskursione disa ditore. Ky bonus jepet një herë për çdo fëmijë për vitin shkollor 2024/25.

Aplikimi mund të bëhet online nga 9 shtatori 2024 deri më 6 korrik 2025, por vetëm pasi të ketë përfunduar ekskursioni.

Dokumentet e nevojshme:

- Plotësimi i formularit të aplikimit online
- Konfirmimi i pjesëmarrjes për ekskursionin e paguar
- Vërtetimi i shtesave të fëmijëve

Nëse i plotësoni kërkesat, ne ju ndihmojmë me kënaqësi gjatë aplikimit!

Ju lutemi caktoni një takim për këshillim me ne: 0676/846954601 ose përmes Emailit: termin@migrare.at